



650/15
25.08.2015



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 589/15

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 nenit si dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej **Hysni Hoxha-Kryetar, Tefik Sylejmani-Referues dhe Ekrem Salihu -Anëtar**, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, e 20 korrik 201, për diskualifikimin e OE “Ekoinvest& G Team” për shkak të falsifikimit të certifikatës PED97/23 EC moduli H/H1, në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së, në seancën e datës 20 gusht 2015, merr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** pjesërisht kërkesa e autoriteti kontraktues Korporatës Energjetike të Kosovës, Nr. 589/15, dt. 20 korrik 2015, për diskualifikimin e OE “Ekoinvest&G Team” nga pjesëmarrja në prokurimin publik për shkak të falsifikimit të certifikatës PED97/23 EC moduli H/H1.
- II. **Diskualifkohet**, OE “G-Team” nga Çekia, për shkak të falsifikimit të certifikatës PED 97/23 EC moduli H/H1, dhe atë në aftë për një vit, që të njëjtit i ndalohet pjesëmarrja në aktivitet e prokurimit publik në Republikën e Kosovës, që nga data 20 gusht 2015 deri me datë 19 gusht 2016.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, më dt. 20 korrik 2015, ka pranuar nga autoriteti kontraktues-Korporata Energjetike e Kosovës, parashtrësën me nr. të protokollit 589/15-propozim për diskualifikim nga procesi i prokurimit konzorciumin “Eko Invest&G-Team”, në të cilën thuhet: me vendimin e OSHP-së, nr. 131/15 të dt. 02 qershor 2015, aktiviteti i prokurimit me nr. KEKC/14/384/511, me titull: Prodhimi, liferimi, instalimi dhe komisionimi i valvave te by-pass te trusnise se larte në dy njësitë TC Kosova B” është kthyer në rivlerësim, dhe një ndër kërkesat me këtë vendim ka qenë edhe verifikimi i autonçitetit të certifikatës PED 97/23 EC moduli H/H1.

Me dt. 24 qershor 2015, autoriteti kontraktues i drejtohet lëshuesit të kësaj certifikate TUV SUF Service GmbH, për verifikimin e autencitetit duke bashkëngjitur edhe certifikatën e dorëzuar nga konzorciumi “Eko Invest&G-Team”. Më dt. 01 korrik 2015, autoriteti kontraktues pranon përgjigjen përmes e-mailit nga TUV SUF Service GmbH, se kompania “G-Team”, nuk është certifikuar me PED moduli H.

Me dt. 02 korrik 2015, autoriteti kontraktues i dërgon operatorit ekonomik (liderit të konzorciumit) njoftimin për eliminim për certifikatën jo valide të prezantuar në ofertë, kurse me dt. 06 korrik 2015, operatori ekonomik “Eko Invest”, përmes shkresës njofton autoritetin kontraktues se përgatitja e ofertës teknike është bërë nga anëtari i konzorciumit “G-Team”.

Duke marrë parasysh që konzorciumin “Eko Invest&G-Team”, kanë prezantuar në ofertën e tyre certifikatë të falsifikuar, kërkojmë nga OSHP-ja konform nenin 99 paragrafi 2 të LPP-së, të shqyrtoj dhe të diskualifikoj konzorciumin “Eko Invest&G-Team”, nga pjesëmarrja në prokurimi publik për një periudhë deri një (1) vit.

Paneli Shqyrtues në seancën e mbajtur me datën: 20 korrik 2015, ku të pranishme ishin përfaqësuesi i OE “Ekoinvest” të cilin e përfaqësoj z. Shefki Asllani, përfaqësuesi i OE “ATM” Gjergj Kostari, përfaqësuesi i AK-së z. Hajzer Zogu si dhe eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik, shqyrtoj shkresën e lëndës: kërkesa e AK KEK, të dt. 20 korrik 2015, me nr. të protokollit 589/15, propozim për diskualifikim nga procesi i prokurimit konzorciumin “Eko Invest&G-Team”, me të cilën kërkohet nga OSHP të veprojnë konform nenit 99 pika 2 të LPP-së , dhe ta përjashtoj konzorciumin “Eko Invest&G-Team” nga pjesëmarrja në prokurimi publik për një periudhë deri një (1) vit.

Në vazhdim të seancës Kryetari i panelit fjalën ia dha përfaqësuesit të autoritetit kontraktues z.Zogu, i cili deklaroj: sipas vendimit të OSHP-së, që të bëhet shqyrtimi i certifikatës edhe njëherë konformë nenit 72 të LPP-së, autoriteti kontraktues KEK gjatë rivlerësimit ka bërë pyetje certifikuesit “TUV SUF Service GmbH”, dhe na është kthyer përgjigje nga prodhuesi i lartpërmendur së anëtari i konzorciumit “G-Team a.s” nuk i është lëshuar kjo certifikatë, dhe se ky anëtar ka bërë vet falsifikimin e saj përmes internetit.

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktues në vazhdim të prezantimit theksoi, pikërisht për këtë ne kemi ndjerë vetën të fyer dhe me pastaj me qenë se kemi pas të bëjmë vetëm me një operator ekonomik të përgjegjshëm jemi detyruar ta anulojmë këtë aktivitet të prokurimit, dhe njëherit i jemi drejtuar OSHP-së, që konformë shkresës nr. 589/15, përmes së cilës kemi kërkuara që ky konzorcium të diskualifikohet konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së.

Në pyetjen e Kryetarit të panelit shqyrtues, se kërkesa e autoritetit kontraktues a është ndaj konzorciumit në tërësi apo vetëm ndaj anëtarit “G-Team a.s”, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues deklaroj: mbesim në tërësi pranë parashtresës së lartcekur për konzorciumin në fjalë.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i OE “ATM”, z. Kostari deklaroj: me qenë se kompania “G-Team a.s”, nuk është prodhues i pajisjeve, na ka lindur dyshimi se certifikata e ofruar nga ata mund të jetë e falsifikuar, pasi ata nuk merren me prodhime të tilla. Ne kemi kërkuar nga OSHP-ja, të verifikoj se certifikata e kontestuar a është falsifikuar apo jo.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i OE “ATM” shtoi së qëndrojnë pranë parashtresës së dt. 06 maj 2015, me Nr. 380/15.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i OE “Eko Invest&G-Team”, z. Asllani deklaroj: sa i përket kësaj çështje nuk kam shumë të shtoj, pasi që çdo gjë është e specifikuar edhe në formularin e tenderit-Deklarata nën Betim, ku secili anëtar i konzorciumit mban përgjegjësin për çdo dokument apo material të ofruar veç e veç, pasi secili anëtar nënshkruan formën e vet.

Përfaqësuesi i OE “Eko Invest&G-Team”, në vazhdim të prezantimit theksoi se certifikata e kontestuar nuk është ofruara nga ne si kompani, por është ofruar nga “G-Team a.s” dhe përgjegjësia i takon plotësisht kompanisë që e ka ofruara certifikatën.

Certifikata e kontestuara, theksoi përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Eko Invets” se nuk ka qenë kërkesës e autoritetit kontraktues, mirëpo anëtari i konzorciumit e ka ofruara të njëjtën dhe dikush ka qenë bërë dijeni se ajo certifikatë mund të jetë fals, kështu që i propozoj panelit të ketë parasysh këto që u thanë më lartë, dhe të mos zbatohet neni 99 të LPP-së.

Në pyetjen e anëtarit të panelit shqyrtues se shkresa-certifikata kontestues cili operator ekonomik në konzorcium e ka ofruar, ju apo partneri i konzorciumi, përfaqësuesi i OE “Ekoinvest”, deklaroj: certifikatën e ka ofruar partneri ynë në konzorcium “G Team a.s”.

Në vazhdim të seancës kryetari i panelit shqyrtues fjalën ia dha ekspertit shqyrtues, i cili deklaroj: meqenëse lëndën e ka shqyrtuar thuajse në tërësi eksperti shqyrtues do ta jap fjalën ekspertit teknik.

Eksperti teknik gjatë seancës dëgjimore deklaroj: meqenëse ne nuk e kemi shqyrtuar shkresën e OE “ATM” si ankesë dhe nuk figuron në raportin tonë, pasi e njëjta ka arritur pas pranimit të autorizimit nga OSHP-ja për shqyrtim të lëndës, dhe njëjta nuk ka qenë ankesë por vetëm njoftim për panelin shqyrtues, ne duke pasur parasysh dispozitat e LPP-së, Rregulloren e punës së OSHP-së, shqyrtojmë vetëm pretendimet ankimore dhe nuk merremi me denoncime të ndryshme.

Në pyetjen e Kryetarit të panelit shqyrtues se certifikata e lartcekur a ka qenë kërkesë e autoritetit kontraktues, si dëshmi për tu dorëzuar, eksperti teknik deklaroj: në kërkesë shënon se valvulat duhet të prodhohen në përputhje me direktivën e pajisjeve nën presion 97/23/EC kategoria 4 moduli H/H1, prandaj operatori ekonomik në ofertë duhet të konfirmoj këtë direktivë, që për mendimin tim i bie që duhet të ketë certifikatën në fjalë. Të njëjtën gjë konfirmon edhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktues z. Zogu.


Në fund të prezantimit eksperti teknik shtoi: në marrëveshjen e konzorciumit të OE “Eko Invest&G-Team” është rregulluar me ligj dhe me dosje se gjithë dokumentacioni që dozohet, thuhet se partneret janë individualisht dhe bashkërisht përgjegjës për dosjen e tenderit deri në realizimin e kontratës.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës si: kërkesa e autoritetit kontraktues Korporatës Energjetike të Kosovës të dt. 20 korrik 2015, me nr. të protokollit 589/15, me të cilën kërkohet nga OSHP-ë të veproj konform neni 99 pika 2 e LPP-së, propozim për diskualifikim nga procesi i prokurimit konzorciumin “Eko Invest&G-Team”, përgjigjen e TUV SUF Servicë GmbH, ku thuhet se s kompania “G-Team”, nuk është certifikuar me PED moduli H, si dhe përgjigjes së KRPP-së, të dt. 13 gusht 2015 ku thuhet: për rastin tuja referoheni Deklaratës nën a. *“Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast që grupit i jepet kontrata për performancën e kontratës”*, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mundë të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesëpadi pranë Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative.

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Hysni Hoxha



Vendimi ti dorëzohet:

1. 1x1 AK – Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.
2. 1x1 OE- “Eko Invest&G-Team”Prishtinë
3. 1x1 Arhivës së OSHP-së